Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0907

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Be New" L.L.C. si dhe ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "G.I. Grafo – Loni" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e Maicave me Llogo për nevoja të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave" me numër të prokurimit 124000-23-9800-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia e Statistikave të Kosovës, më 19/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si të pabazuara ankesat e Operatorit Ekonomik (OE) "Be New " L.L.C me nr. 2023/0907 e datës 15/11/2023, si dhe ankesa e Operatorit Ekonomik (OE) "G.I. Grafo – Loni" SH.P.K me nr. 2023/0910 e datës 16/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e Maicave me Llogo për nevoja të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave", me numër të prokurimit 124000-23-9800-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Agjencia e Statistikave të Kosovës.

2.Mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues (AK)- ASK për anulim të aktivitetit të prokurimit "Blerja e Maicave me Llogo për nevoja të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave", me numër të prokurimit 124000-23-9800-1-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.09.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e Maicave me

Llogo për nevoja te Regjistrimit te Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave" me nr. të prokurimit: "124000-23-9800-1-2-1".Autoriteti Kontraktues – Agjencia e Statistikave të Kosovës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës furnizim. Vlera e parashikuar 122,600.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Me 06. 11. 2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 08.11.2023, OE "Be New LLC" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Anulim të cilën AK e ka refuzuar me datën 10.11.2023.

Me datë 10.11.2023, po ashtu edhe OE "G.I. Grafo – Loni" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Anulim të Autoritetit Kontraktues. AK të njëjtën kërkesë me datën 13.11.2023 e ka refuzuar.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Be New" L.L.C ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2023/0907 me datën 15/11/2023. Poashtu, OE ankues "G.I. Grafo – Loni" SH.P.K ka parashtruar ankesë me nr. 2023/0910 me datën 16/11/2023 për të njëjtin aktivitet te prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 907/23 dhe ankesa nr. 910/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit "Be New" L.L.C

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik me të cilin konstaton se AK, pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim te po këtij operatori ekonomik me datën 24.10.2023 dhe trajtimit te pretendimeve te tij, me datën 25.10.2023 ka marr vendim dhe ka kthyer lenden ne rivlerësim dhe me rastin e rivlerësimit te ofertave komisioni i vlerësimit duke vepruar konform kërkesave dhe specifikave teknike te parashtruara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimit për kontrate dhe duke trajtuar te gjithë operatoret ekonomik konform nenit 7 dhe 59 te LPP-se ka vlerësuar ofertat e operatoreve ekonomik dhe ka analizuar mostrat e dorëzuara nga secili operator ekonomik dhe mbi bazën e analizave te këtyre mostrave ka nxjerrur rezultat te faktuar edhe me foto se asnjeri nga operatoret ekonomik pjesëmarrës nuk i ka dorëzuar

mostrat sipas specifikave teknike te paraqitura me dosjen e tenderit dhe konform kërkesës se parashtruar ne FTD dhe njoftimit për kontrate tek pika b) te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është specifikuar si vijon: Kërkesa: b. Operatori ekonomik duhet së bashku me ofertat të dorëzoj nga një mostër për produktet e kërkuara/pjese e këtij tenderi. Dëshmia: b. Mostrat e artikujve te kërkuara, duhet të dorëzohen të paketuara. Para datës se hapjes se ofertës jo me vone se data 25.09.2023 ora 14:00 ne zyrën e prokurimit ne ASK. Dhe me qene se asnjëri nga operatoret ekonomik nuk i ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës se lartcekur respektivisht specifikave te dhëna ne DT aneksi 1, janë eliminuar dhe me rastin e publikimit te njoftimit mbi vendimit e AK përmes letrës standarde secili nga operatoret ekonomik pjesëmarrës janë informuar lidhur me arsyet e eliminimit te tyre përfshirë edhe operatorin ekonomik i cili ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim. Operatori ekonomik "Be New" L.L.C. është i pasuksesshëm për arsye se ka dorëzuar mostrat e maicave te cilat nuk janë konform specifikave te parapara me aneksin 1 te dosjes se tenderit, me konkretisht është specifikuar: Maicë me ngjyra, qepje të dyfishta në pjesën e poshtme, mëngë dhe fund, qepje shtesë përgjatë shpatullës, jakë e përforcuar me shirit Pesha neto 0.11 kg. Materiali Pambuk Gram 150 g/ m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët OE ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (S) ku pesha e maicës është 117 gr total. Maicë me ngjyra pambuku pollo, 180 g / m2, e qepur anash, qepje e dyfishtë në pjesën e poshtme, vrapim rreth mëngëve, tre butona në ngjyrë të këmishës, buton rezervë, i përforcuar me një fjongo përgjatë qafës dhe një thurje shtesë përgjatë shpatullës Pesha neto 0.20 kg Materiali Pambuk Gram 180 g/ m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët. OE ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (M) ku pesha e Maicës është 215 gr total / toleranca minus 5% =10.75 Totali:204.25 gr. si dhe nuk ka buton rezervë. Në shqyrtim u vërtetua se Autoritetit Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar konform kërkesave të parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate si dhe konform me nenin 59 dhe 62 të LPP-së ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti sepse asnjeri nga operatoret pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit nuk i ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës se vendosur ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate respektivisht specifikave teknike te përshkruara ne aneksin 1 te dosjes.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit "G.I. Grafo–Loni" Sh.P.K

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik me të cilin konstaton se AK, pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim te po këtij operatori ekonomik me datën 24.10.2023 dhe trajtimit te pretendimeve te tij, me datën 25.10.2023 ka marr vendim dhe ka kthyer lenden ne rivlerësim dhe me rastin e rivlerësimit te ofertave komisioni i vlerësimit duke vepruar konform kërkesave dhe specifikave teknike te parashtruara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimit për kontrate dhe duke trajtuar te gjithë operatoret ekonomik konform nenit 7 dhe 59 te LPP-se ka vlerësuar ofertat e e operatoreve ekonomik dhe ka analizuar mostrat e dorëzuara nga secili operator ekonomik dhe mbi bazën e analizave te këtyre mostrave ka nxjerrur rezultat te faktuar edhe me foto se asnjeri nga operatoret ekonomik pjesëmarrës nuk i ka dorëzuar mostrat sipas specifikave teknike te paraqitura me dosjen e tenderit dhe konform kërkesës se parashtruar ne FTD dhe njoftimit për kontrate tek pika b) te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është specifikuar si vijon: Kërkesa: b. Operatori ekonomik duhet së bashku me ofertat të dorëzoj nga një mostër për produktet e kërkuara, pjesë e këtij tenderi. Dëshmia: b. Mostrat e artikujve te kërkuara, duhet të dorëzohen të paketuara. Para datës se hapjes se ofertës jo me vone se data 25.09.2023 ora 14:00 ne zyrën e prokurimit ne ASK. Dhe me qene se asnjëri nga operatoret ekonomik nuk i ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës se

lartcekur respektivisht specifikave te dhëna ne DT aneksi 1, janë eliminuar dhe me rastin e publikimit te njoftimit mbi vendimit e AK përmes letrës standarde secili nga operatoret ekonomik pjesëmarrës janë informuar lidhur me arsyet e eliminimit te tyre përfshirë edhe operatorin ekonomik i cili ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim. Operatori ekonomik "Be New" L.L.C. është i pasuksesshëm për arsye se ka dorëzuar mostrat e maicave te cilat nuk janë konform specifikave te parapara me aneksin 1 te dosjes se tenderit, me konkretisht është specifikuar: 1. Maicë me ngjyra, qepje të dyfishta në pjesën e poshtme, mëngë dhe fund, qepje shtesë përgjatë shpatullës, jakë e përforcuar me shirit Pesha neto 0.11 kg. Materiali Pambuk Gram 150 g/m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët. OE ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (S) ku pesha e maicës është 117 gr total. 2. Maicë me ngjyra pambuku pollo, 180 g / m2, e qepur anash, qepje e dyfishtë në pjesën e poshtme, vrapim rreth mëngëve, tre butona në ngjyrë të këmishës, buton rezervë, i përforcuar me një fjongo përgjatë qafës dhe një thurje shtesë përgjatë shpatullës Pesha neto 0.20 kg Materiali Pambuk Gram 180 g/m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët. OE ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (M) ku pesha e Maicës është 215 gr total / toleranca minus 5% =10.75, Totali:204.25 gr. si dhe nuk ka buton rezervë. Dëshmi foto e realizuara nga komisioni me rastin e vlerësimit dhe matjes se mostrave te maicave te OE "Be New L.L.C". Në shqyrtim u vërtetua se Autoritetit Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar konform kërkesave të parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate si dhe konform me nenin 59 dhe 62 të LPP-së ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti sepse asnjeri nga operatoret pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit nuk i ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës se vendosur ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate respektivisht specifikave teknike te përshkruara ne aneksin 1 te dosjes.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Be New" LLC janë parashtruar si në vijim:

- Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit. Në bazë të formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues- Agjencia e Statistikave të Kosovës me dt: 06.11.2023, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimi ....." edhe pas ri vlerësimit të ofertave Operatoret ekonomik kanë dorëzuar mostra te maicave të cilat nuk i përmbushin specifikimet teknike te përshkrimit të maicave andaj të gjithë OE janë të pasuksesshëm në ofertën e tyre. Andaj komisioni i vlerësimit rekomandon njësinë e prokurimit qe të anuloj këtë aktivitet të prokurimit ne mungesë te ofertave te përgjegjshme." Ndërsa AK sipas B42 letrës standarde për tenderuesin e eliminuar për operatorin ekonomik "Be New" L.L.C, të datës 06.11.2023, ka potencuar: Operatori ekonomik "Be New" L.L.C, është i pa suksesshëm për arsye te përshkrimit teknik që duhet të realizohet. 1.Maicë me ngjyra qepje të dyfishta në pjesën e poshtme mëngë dhe fund qepje shtesë përgjatë shpatullës jakë e përforcuar me shirit Pesha neto 0.11 kg. Matriali pambuk Gram 150 g/m2 me logo color DTF PRINT ne të dy anët ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (S) ku pesha e maicës është 117 gr total. 2.Maicë me ngjyra pambuku pollo, 180g/m2 e qepur anash, qepje e dyfishtë në pjesën e poshtme vrapim rreth mëngëve, tre butona në ngjyrë të këmishës, buton rezervë i përforcuar me një fjongo përgjatë qafës dhe një thurje shtesë përgjatë shpatullës Pesha neto 0.20 kg Materiali Pambuk Gram 180g/m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (M) ku pesha e Maicës është 215gr total/toleranca minus 5%=10.75 Totali:204.25 gr si dhe nuk ka buton rezervë. I pa kënaqur me njoftim e AK-së, OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë:08.11.23. Ndërsa AK me datë 10.11.202, përmes vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe lenë ne fuqi njoftimin mbi vendimin për anulim. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore,

operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28, 59, 60 dhe 61, të LPP-së. OE ankues pretendon se është eliminuar pa të drejte nga AK se oferta e tyre është e përgjegjshme dhe kanë ofruar çmimin me të lirë dhe rrjedhimisht do duhen të shpallen fitues tutje. OE ankues shtonë se i plotësojnë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe specifikat teknike te dhëna në Aneksin 1. Arsyetimi për eliminimin e ofertës se tyre janë të pa qëndrueshme për faktin se matjet qe janë prezantuar ne vendim janë krejtësisht të paqëndrueshme me qe këto matje janë realizuar me peshore jo profesionale (peshore e thjeshtë dhe njësinë matëse e ka (kg), përderisa produkti peshon me (gr) atëherë saktësia e matjes është me gabime te mëdha) dhe nga njerëzit jo kompetente dhe ka reflektuar edhe me gabime ne peshimin e produktit. OE ankues pretendon se bazuar në nenin 59.4 të LPP-së, sasia për artikullin 2 prej 100 copë ne raport me sasinë kryesore artikulli 1, prej 20000 copë, mos vendosja e një pulle rezerve në mostër është një devijim krejtësisht i pa përfillshim pasi qe produkti i prezantuar i plotëson kërkesat teknike 100% (përmbajtja e materialit 100% pambuku me 180 GSM/m2, pesha e produktit total është brenda peshës së kërkuar me tolerance +-5%. AK për matje/peshim profesional do duhej të angazhoje kompani profesionale qe janë te certifikuara dhe akredituara për peshim profesional. Tutje OE Ankues ka propozuar një kompani që bene peshimin dhe njëjti ka bashkangjitur dhe linkun.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "G.I Grafo Loni" janë parashtruar si në vijim:

- Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit. Në bazë të formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Agjencia e Statistikave të Kosovës me dt: 06.11.2023, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimi ....."edhe pas ri vlerësimit të ofertave Operatoret ekonomik kanë dorëzuar mostra te maicave të cilat nuk i përmbushin specifikimet teknike te përshkrimit të maicave andaj të gjithë OE janë të pasuksesshëm në ofertën e tyre. Andaj komisioni i vlerësimit rekomandon njësinë e prokurimit qe të anuloj këtë aktivitet të prokurimit ne mungesë te ofertave te përgjegjshme." Ndërsa AK sipas B42 letrës standarde për tenderuesin e eliminuar për operatorin ekonomik G.I.Grafo-Loni SH.P.K, të datës 06.11.2023, ka potencuar: Operatori ekonomik G.I.Grafo-Loni SH.P.K, është i pa suksesshëm edhe pse është operatori me çmimin më të ulët por tek përshkrimi teknik që duhet të realizohet. 1.Maicë me ngjyra qepje të dyfishta në pjesën e poshtme mëngë dhe fund qepje shtesë përgjatë shpatullës jakë e përforcuar me shirit Pesha neto 0.11 kg. Materiali pambuk Gram 150 g/m2 me logo color DTF PRINT ne të dy anët ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (L) ku pesha e maicës është 173 gr total/toleranca minus 5%=8.65 164.35-8.21(toleranca minus 5% M) Totali:156.14 gr. 2.Maicë me ngjyra pambuku pollo, 180g/m2 e qepur anash, qepje e dyfishtë në pjesën e poshtme, vrapim rreth mëngëve, tre butona në ngjyrë të këmishës, buton rezervë i përforcuar me një fjongo përgjatë qafës dhe një thurje shtesë përgjatë shpatullës Pesha neto 0.20 kg Materiali Pambuk Gram 180g/m2 me logo color DTF PRINT ne te dy anët ka dorëzuar mostrën e maicës me madhësi (XL) ku pesha e Maicës është 240gr total/toleranca minus 5%=12.00 228-11.4 (toleranca minus 5% e L) 216.6-10.83(toleranca minus 5% e M) Totali:205.77 gr. I pa kënaqur me njoftim e AK-së, OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë:10.11.23. Ndërsa AK me datë 13.11.202, përmes vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe lenë në fuqi njoftimin mbi vendimin për anulim. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së. OE ankues pretendon se është eliminuar pa të drejte nga AK, dhe se të gjitha mostrat i kanë sipas specifikave teknike. Tutje OE ankues shton se është plotësisht i gabuar arsyetimi i komisionit të vlerësimit se në jemi të

papërgjegjshëm për faktin se tek specifikat teknike ju keni kërkuar që pesha e maicës te jetë 150/m2 e materialit dhe jo maicës si tërësi dhe me ketë konstatim të gabuar ka ardhur deri te eliminimi i kompanisë sonë. Më poshtë keni pyetjen tonë dhe përgjigjen e kompanisë distributor se matja e peshës totale të maicës është e gabuar dhe se të gjitha pozicionet të cilat i keni kërkuar në dosjen e tenderit janë 100% në përputhje me specifikat teknike.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.11.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 907/23 dhe 910/23 e cila me datë 04.12.2023 ka dorëzuar raportet e ekspertizës.

Lidhur me ankesën nr. 907/23 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: "*ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit*".

Konstatimet e ekspertes shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 907/23 të operatorit ekonomik "Be New" LLC

- Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të arsyeve të eliminimit për operatorët ekonomik pjesëmarrës, sqaron se kanë ofertuar gjithsej dhjetë (10) operator ekonomik, ku AK i ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomik me arsyetimin se janë të papërgjegjshëm dhe kanë ofruar motrat jo sipas specifikimit teknik. Sido që të jetë, ekspertja shqyrtuese do të jep përgjigje në pretendimet e OE ankues, ku në bazë të shkresave të lëndës sqaron se AK në dosje të tenderit kishte kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 të jetë 200 gram (0.20 kg) me material nga pambuku me 180 gram për metër katror, ndërsa për peshën prej 200 gram lejohet devijimi prej 5%, varësisht nga madhësia e maicës (S, M, L apo XL), si dhe AK kishte kërkuar 50 copë të madhësisë M, 100 copë të madhësisë L dhe 50 copë të madhësisë XL. Lidhur me peshën prej 200 gram, në bazë të sqarimeve të tenderit, një prej pyetje në lidhje me devijimin e peshës ishte: "pesha e maicës nuk mund të jetë pa tolerancë sepse M ka material 30% më pak se XL", kurse AK kishte dhënë këtë sqarim: "Pesha e maicës ka tolerancë në mes madhësive konform ligjit pra plus – minus 5%.". Në bazë të këtij sqarimi të dosjes së tenderit, kuptohet që pavarësisht madhësisë së maicës, lejimi maksimal i devijimit nga pesha prej 200 gram te pozicioni numër 2 është 5%, ndërsa asnjë prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës nuk e ka kontestuar nëse është e mjaftueshme lejimi për devijim prej 5%. Në bazë të këtij lejimi të devijimit prej 5%, ekspertja shqyrtuese sqaron se nga kriteri bazë i dosjes së tenderit është kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 është 200 gram dhe meqenëse lejimi i ndryshimit të peshës është 5%, atëherë kufiri minimal i peshës së lejuar është 190 gram, kurse kufiri maksimal i peshës së lejuar është 210 gram. Pas matjeve të bëra nga autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave, ka rezultuar se pesha e maicës me madhësi XL është 240 gram, që do të thotë se e kalon kufirin maksimal prej 210 gram.
- Sa i përket e-mailit të distributorit, cilin e ka dorëzuar OE ankues me ankesë, ku jepen sqarime se "maica nuk vlerësohet në bazë të peshës sepse prej madhësisë S deri te madhësisë XXL ndryshojnë dhe pesha e kërkuar 150gr/m2 nuk d.m.th. se maica të jetë 150 gram kur të peshohet por për 1m2 ka 150gr.", ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky sqarim i dhënë është dashur të kërkohet që të bëhet në dosje të tenderit, mirëpo asnjëri prej OE nuk e kishte parë të arsyeshme që ti kontestoj kriteret e vendosura në dosje të tenderit. Për më tepër, në sqarimin e tenderit, ku një prej OE kishte parashtruar pyetje se ndryshimi i peshës është 30% prej

numrit më të vogël deri te numri më i madh, asnjë prej OE nuk kishte kërkuar që të ndryshohet kriteri i lejimit të devijimit prej 5%. Përderisa të gjithë operatorët ekonomik janë pajtuar me këto kritere, tani në fazën të cilën gjendet ky aktivitet i prokurimit duhet të vlerësohet me kriteret të cilat janë pranuar nga të gjitha palët. Neni 59 par.4 i LPP-së ka përcaktuar: 4."Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...". Andaj, vlerësoj që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nëse në të ardhmen ka interes për të njëjtin aktivitet të prokurimit, AK të ketë parasysh përpilimin e kërkesave të dosjes së tenderit nga njerëz profesional për shkak se lejimi prej 5% devijim nga numri më i vogël (S) deri te numri më i madh (XL), praktikisht është i pamundshëm sepse numri XL mund të marr pothuajse dyfishin e materialit në krahasim me numrin më të vogël (S).

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatori ekonomik nuk është deklaruar.

Lidhur me ankesën nr. 910/23 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: "*ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit*".

Konstatimet e ekspertes shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 910/23 të operatorit ekonomik "G.I Grafo Loni" Sh.P.K

- Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të arsyeve të eliminimit për operatorët ekonomik pjesëmarrës, sqaron se kanë ofertuar gjithsej dhjetë (10) operator ekonomik, ku AK i ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomik me arsyetimin se janë të papërgjegjshëm dhe kanë ofruar motrat jo sipas specifikimit teknik. Sido që të jetë, ekspertja shqyrtuese do të jep përgjigje në pretendimet e OE ankues, ku në bazë të shkresave të lëndës sqaron se AK në dosje të tenderit kishte kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 të jetë 200 gram (0.20 kg) me material nga pambuku me 180 gram për metër katror, ndërsa për peshën prej 200 gram lejohet devijimi prej 5%, varësisht nga madhësia e maicës (S, M, L apo XL), si dhe AK kishte kërkuar 50 copë të madhësisë M, 100 copë të madhësisë L dhe 50 copë të madhësisë XL. Lidhur me peshën prej 200 gram, në bazë të sqarimeve të tenderit, një prej pyetje në lidhje me devijimin e peshës ishte: "pesha e maicës nuk mund të jetë pa tolerancë sepse M ka material 30% më pak se XL", kurse AK kishte dhënë këtë sqarim: "Pesha e maicës ka tolerancë në mes madhësive konform ligjit pra plus – minus 5%.". Në bazë të këtij sqarimi të dosjes së tenderit, kuptohet që pavarësisht madhësisë së maicës, lejimi maksimal i devijimit nga pesha prej 200 gram te pozicioni numër 2 është 5%, ndërsa asnjë prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës nuk e ka kontestuar nëse është e mjaftueshme lejimi për devijim prej 5%. Në bazë të këtij lejimi të devijimit prej 5%, ekspertja shqyrtuese sqaron se nga kriteri bazë i dosjes së tenderit është kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 është 200 gram dhe meqenëse lejimi i ndryshimit të peshës është 5%, atëherë kufiri minimal i peshës së lejuar është 190 gram, kurse kufiri maksimal i peshës së lejuar është 210 gram. Pas matjeve të bëra nga autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave, ka rezultuar se pesha e maicës me madhësi XL është 240 gram, që do të thotë se e kalon kufirin maksimal prej 210 gram.
- Sa i përket e-mailit të distributorit, cilin e ka dorëzuar OE ankues me ankesë, ku jepen sqarime se "maica nuk vlerësohet në bazë të peshës sepse prej madhësisë S deri te madhësisë XXL ndryshojnë dhe pesha e kërkuar 150gr/m2 nuk d.m.th. se maica të jetë 150 gram kur të

peshohet por për 1m2 ka 150gr.", ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky sqarim i dhënë është dashur të kërkohet që të bëhet në dosje të tenderit, mirëpo asnjëri prej OE nuk e kishte parë të arsyeshme që ti kontestoj kriteret e vendosura në dosje të tenderit. Për më tepër, në sqarimin e tenderit, ku një prej OE kishte parashtruar pyetje se ndryshimi i peshës është 30% prej numrit më të vogël deri te numri më i madh, asnjë prej OE nuk kishte kërkuar që të ndryshohet kriteri i lejimit të devijimit prej 5%. Përderisa të gjithë operatorët ekonomik janë pajtuar me këto kritere, tani në fazën të cilën gjendet ky aktivitet i prokurimit duhet të vlerësohet me kriteret të cilat janë pranuar nga të gjitha palët. Neni 59 par.4 i LPP-së ka përcaktuar: 4."Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..." Andaj, vlerësoj që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nëse në të ardhmen ka interes për të njëjtin aktivitet të prokurimit, AK të ketë parasysh përpilimin e kërkesave të dosjes së tenderit nga njerëz profesional për shkak se lejimi prej 5% devijim nga numri më i vogël (S) deri te numri më i madh (XL), praktikisht është i pamundshëm sepse numri XL mund të marr pothuajse dyfishin e materialit në krahasim me numrin më të vogël (S).

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatoret ekonomik që të dy nuk janë deklaruar fare lidhur me raportin.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesave të dorëzuar me numër protokolli Nr. 907/23 dhe Nr. 910/23, sqaron se konstatimet në raportin e ekspertes shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues "Be New" LLC dhe "G.I Grafo Loni" Sh.P.K i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertes dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara**.**

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 62 të LPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur ta lejë në fuqi vendimin e AK, saktësisht njoftimin për anulim të kontratës të publikuar me datën 06.11.2023 nga autoriteti kontraktues si të bazuar në nenin 62 të LPP-së si ligj material, duke theksuar faktin se anulimi i këtij aktiviteti të

prokurimit është bërë në mungesë të ofertave të përgjegjshme, pasiqë të dhjetë (10) operatoret ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, përfshirë këtu edhe Ankuesit, nuk kanë përmbushur kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për të cilat kritere të vendosura Ankuesit nuk janë ankuar në fazën e Njoftimit për Kontratë duke vendosur të mos i kontestojnë këto kritere të vendosura nga AK.

Duke marrë për bazë sqarimet e dhëna nga ekspertja shqyrtuese, paneli shqyrtues konstaton se AK në dosje të tenderit kishte kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 të jetë 200 gram (0.20 kg) me material nga pambuku me 180 gram për metër katror, ndërsa për peshën prej 200 gram lejohet devijimi prej 5%, varësisht nga madhësia e maicës (S, M, L apo XL). Gjithashtu, AK kishte kërkuar 50 copë të madhësisë M, 100 copë të madhësisë L dhe 50 copë të madhësisë XL. Lidhur me peshën prej 200 gram, në bazë të sqarimeve të tenderit, një prej pyetje në lidhje me devijimin e peshës ishte: "pesha e maicës nuk mund të jetë pa tolerancë sepse M ka material 30% më pak se XL". AK në përgjigje kishte dhënë këtë sqarim: "Pesha e maicës ka tolerancë në mes madhësive konform ligjit pra plus – minus 5%.". Në bazë të këtij sqarimi të dosjes së tenderit, kuptohet që pavarësisht madhësisë së maicës, lejimi maksimal i devijimit nga pesha prej 200 gram te pozicioni numër 2 është 5%, ndërsa asnjë prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës nuk e ka kontestuar nëse është e mjaftueshme lejimi për devijim prej 5%. Në bazë të këtij lejimi të devijimit prej 5%. Nga kriteri bazë i dosjes së tenderit është kërkuar që pesha neto për pozicionin numër 2 është 200 gram dhe meqenëse lejimi i ndryshimit të peshës është 5%, atëherë kufiri minimal i peshës së lejuar është 190 gram, kurse kufiri maksimal i peshës së lejuar është 210 gram. Pas matjeve të bëra nga autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave, ka rezultuar se pesha e maicës me madhësi XL është 240 gram, që do të thotë se e kalon kufirin maksimal prej 210 gram sipas kerkeses se AK.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe gjatë hartimit të kritereve të dosjes së tenderit të mos hartojë specifikime teknike që bien ndesh me dispozitat e LPP-së. Mirëpo, marrë për bazë faktin se aktiviteti i prokurimit është anuluar në mungesë të ofertave të përgjegjshme, bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se vendimi i AK-së duhet të mbetet në fuqi për arsyet e dhëna si më lartë dhe nëse në të ardhmen ka interes për të njëjtin aktivitet të prokurimit, AK të ketë parasysh përpilimin e kërkesave të dosjes së tenderit nga ana komisioneve profesionale për shkak se lejimi prej 5% devijim nga numri më i vogël (S) deri te numri më i madh (XL), praktikisht është i pamundshëm sepse numri XL mund të marr pothuajse dyfishin e materialit në krahasim me numrin më të vogël (S). Paneli gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues**nuk duhet** që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën

OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
- OE - **" BE NEW " L.L.C., G.I.Grafo - Loni SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: